



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Datë/a:	25.11.2021
Referenc-ë:	07-353/04-253915/21
Për/ Za/ To:	OJQ "Kuvendi rinor i Prishtinës" – Arbër Krasniqi
Përmes/Preko/Through:	Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim

Drejtorija për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën me nr protokolli 07-353/04-253915/21 nga OJQ "Kuvendi rinor i Prishtinës" me përfaqësues Arbër Krasniqi me të cilën kërkohet që me datë 28 Nëntor 2021 nga të bëhet shfrytëzimi i hapësirës publike, Sheshi "Nëna Terezë" me qëllim të realizimit të ekspozitës të pikturave në kuadër të projektit "Historia dhe Arti".

Qëllimi i kërkesës është promovimi i artistëve të rijë ku do të ekspozojnë veprat e tyre nga ora 12:00 deri në 15:00.

Drejtorija pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për "Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronë Publike" me nr.01-110-157481, jep pëlqimin OJQ "Kuvendi rinor i Prishtinës" me përfaqësues Arbër Krasniqi për shfrytëzimin e hapësirës publike në Sheshin "Nëna Terezë" me datën 28 Nëntor 2021 nga ora 12:00 deri në 15:00 për realizimin e ekspozitës sipas kërkesës së parashtruar.

Kushtet e pëlqimit:

- Nuk lejohet dëmtimi i pronës publike dhe çdo dëmtim eventual si pasojë e këtij aktiviteti do të jetë përgjegjësi e juaja;
- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi;
- Mos të pengohet lëvizja e lirë e qytetarëve;
- Pas përfundimit të aktivitetit hapësira të kthehet në gjendjen e më parshme.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.

25.11.2021

Faqe 1 nga 1